



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Zyra e Prokurimit - Komuna Junik

Datë: 29.04.2020

Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 108/A, paragrafi 6 dhe 10, pika 10.1 dhe Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës: 16.04.2020, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim (ankesës) të parashtruar nga grupi i Operatorëve Ekonomik, "Arfa Group". sh. p. k dhe "Euroasphalt". sh. p. k, Deçan, Gjakovë, të datës: 27.04.2020, lidhur me tenderin "Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë", me numër të brendshëm të prokurimit: 636-19-022-511 dhe me numër të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1, të shpallur me dt. 17.07.2019, Zyra e Prokurimit mori këtë:

VENDIM

- I. Refuzohet** si e pabazë kërkesa për ri-shqyrtim (ankesa) nga grupi i Operatorëve Ekonomik, "Arfa Group". sh. p. k dhe "Euroasphalt". sh. p. k, e parashtruar me datën: 27.04.2020, lidhur me tenderin: "Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë", me numër të brendshëm të prokurimit: 636-19-022-511 dhe me numër të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1.
- II. Mbetet në fuqi** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Komuna Junik i datës 16.04.2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi** pas ditës së nënshkrimit të këtij vendimi.

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues Komuna Junik, shqyrtoi kërkesën për ri-shqyrtim të datës: 27.04.2020, të pranuar përmes sistemit elektronik E-Prokurimi e parashtruar nga grupi i Operatorëve Ekonomik, "Arfa Group". sh. p. k dhe "Euroasphalt". sh. p. k, Deçan, Gjakovë duke analizuar të gjitha faktet e ofruara nga grupi i operatorëve ekonomik në fjalë dhe bazuar në neni 108/A, paragrafi 10, pika 10.1, të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, të njëjtën e refuzoi si të pa bazuar për këto arsye:

Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë në web faqen zyrtare të E-Prokurimit.

Provë: Njoftimi i Publikuar në web faqen zyrtare të E- Prokurimit.

Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me ri-vlerësimin e lëndës me titull: "Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë", Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit në fjalë dhe menjëherë ka pezulluar aktivitetin e prokurimit.

Provë: Njoftim për pezullim

Në vazhdim ashtu siç parashihet në neni 108/A, paragrafi 10, pika 10.1, të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik jep përgjigje me shkrim parashtruesit të ankesës, grupit të Operatorëve Ekonomik, "Arfa Group". sh. p. k dhe "Euroasphalt". sh. p. k, Deçan, Gjakovë lidhur me pretendimet e bëra në kërkesën për rishqyrtim (ankesën) :

Pas vendimit të datës:18.03.2020 me nr. 100/111/20 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit- Paneli Shqyrtues i emëruar nga Kryetari i OSHP- së, që aktiviteti i prokurimit me titull: Ndërtimi rrugës Junik- Gjeravicë të ri-vlerësohet, Autoriteti Kontraktues e respektoi vendimin e OSHP- së dhe e formoi komisionin e ri për ri-vlerësimin e lëndës me titull: Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë.

Mirëpo, bazuar në paragrafi II të këtij vendimi (Vendimin nr.100/111/20) të Organit Shqyrtues të Prokurimit- Panelit Shqyrtues, ankesa juaj kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- Komuna Junik hidhet poshtë si e palejuar sepse bazuar në Vendimin nr.1149/19 të Panelit Shqyrtues ju jeni në listën e zezë të Operatorëve Ekonomik dhe e keni të pamundur të zhvilloni aktivitetet e prokurimit deri në një periudhë të caktuar kohore.

Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik bazuar në nenin 4, paragrafin 1.26 të Ligjit të Prokurimit Publik në fuqi si dhe duke marrë në konsideratë Vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit- Panelit Shqyrtues për këtë aktivitet të prokurimit refuzon kërkesën tuaj për rishqyrtimin e lëndës në fjalë pasi që konsideroheni palë pa interes juridik e material për këtë aktivitet të prokurimit si dhe të njejtën kërkesë për rishqyrtim me të vetmin ndryshim datën, Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik e ka pranuar edhe me herët pra, me dt.03.02.2020 dhe të njejtën e ka refuzuar si të pabazuar.

Provë: Vendimi i OSHP 100/111/20

Njoftim mbi vendimin e AK

Vendimi ndaj kërkesës për ri-shqyrtim 06.02.2020

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të parashtroi ankesë konform Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 109 pika 2 në OSHP.

U.D.Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit:



Aktvendimi ti dorëzohet:

- Zyrës së Prokurimit
- Grupi i OE," Arfa Group". sh. p. k dhe "Euroasphalt". sh. p. k
- Arkivit të Komunës